



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:275676

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05554048

KA.nr. 286/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.SH. “Miqësia” me numër unik identifikues 810628480 me seli në Suharekë, fshati Kushnicë e Poshtme, kundër të paditurit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, për shkak anulimit të vendimit A-57/19 të datës 16.04.2019 dhe vendimit 05 nr.350/02-0215128/18 të datës 02.11.2018, jashtë seancës, më datë 05.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me nr. KA.nr.286/22 e paditësit N.T.SH. “Miqësia” me numër unik identifikues 810628480 me seli në Suharekë, kundër të paditurit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, për shkak anulimit të vendimit A-57/19 të datës 16.04.2019 dhe vendimit 05 nr.350/02-0215128/18 të datës 02.11.2018, për arsye se paditësi nuk e ka plotësuar padinë sipas aktvendimit të gjykatës të datës 19.12.2023.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.SH. “Miqësia” me numër unik identifikues 810628480 me seli në Suharekë, pranë kësaj gjykate ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit A-57/19 të datës 16.04.2019 dhe vendimit 05 nr.350/02-0215128/18 të datës 02.11.2018 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Gjykata me datë 18.12.2023 ka caktuar seancën në rigjykim, në të cilën seancë nuk kanë prezantuar përfaqësuesit e autorizuar të paditësit dhe të paditurit edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata me Aktvendimin KA.nr. 286/22 të datës 19.12.2023 ka ftuar përfaqësuesin e paditësit që të bëjë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv ashtu që të përcaktoj në mënyrë të saktë paditësi dhe e ka paralajmëruar se nëse nuk i mënjanon të metat e padisë, gjykata do ta hedh poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 të LKA-së.

Përfaqësuesi i paditësi edhe pse me datë 03.01.2024 e ka pranuar Aktvendimin KA.nr. 286/22 të datës 19.12.2023 për plotësimin e padisë, i njëjti nuk ka vepruar sipas tij, pra nuk e ka bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv brenda afatit të përcaktuar, andaj duke pasur parasysh faktin që të metat e padisë janë të atilla që e pa mundësojnë zhvillimin e procedurës gjyqësore në këtë konflikt administrativ, gjykata në pajtim me nenin 33.2 të LKA-së vendosi ta hedh poshtë padinë e paditësit.

Neni 33 par.2 i LKA-së përcakton se: *“Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.”*

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 33 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.286/22, datë 05.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.